

Ditari Natyrës


Në këtë numër do të gjeni:

- Trainimi i Parë i projektit SEA_Med.
- Vlerësim për ecurinë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës gjatë vitit të parë.
- Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar Karaburun - Sazan.
- Zhvillimi i aftësive të komunikimit të stafit të Zonave të Mbrojtura.
- Ekomuzeumi i lumit Vjosa/Aoos kundërshton devijimin e planifikuar të këtij lumi.
- 22 Mars, Dita Botërore e Ujit.
- Vazhdon vlerësimi i vlerave dhe përfitimeve nga Parqet Kombëtare.
- Njoftime.

Trainimi i Parë i Projektit SEA_Med.

Vlorë, 29 Mars - 5 Prill 2014

Trajnimi i Parë Rajonal i projektit SEA-Med është duke u zhvilluar në qytetin e Vlorës, në afërsi të Zonës së Mbrojtur Detare të Karaburun-Sazanit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Algjeria, Libia, Tunizia, Turqia, Kroacia, Greqia, Gjermania, Italia, SHBA dhe Shqipëria, të cilët janë duke ndërmarrë trajnime dhe aktivitete njohëse në kuadër të projektit shumëkombësh mbi "Aktivitetet Ekonomike të Qëndrueshme në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut", me asistencën e WWF Med-PO dhe NOAA (Administrata Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike, SHBA).



Vlerësim për ecurinë e Rrjetit gjatë vitit të parë!

Tiranë, 4 Mars 2014



RRJETI PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Në kuadër të zbatimit të programit SENiOR-A, Ambasada Suedeze ka zhvilluar procesin e monitorimit të ecurisë së programit SENiOR-A. Përfaqësues të Ambasadës Suedeze së bashku me përfaqësues të REC Shqipëri, zhvilluan një vizite në zyrat e organizatës INCA-s së bashku me menaxherin dhe koordinatoren e këtij programi. Diskutimi ishte i fokusuar në aktivitetet kryesore që ka zhvilluar rrjeti gjatë vitit të parë të punës si dhe bashkëpunimin mes rrjeteve e cila erdhi edhe në formën e një sugjerimi nga përfaqësuesit e misionit. Në këtë drejtim INCA ka hedhur tashmë hapat e para të bashkëpunimit edhe me organizata të cilat mbështesin gratë dhe të rinjtë dhe vitin e ardhshëm

rezultatet do të jenë me të dukshme.

Rrjeti për Mbrojtjen e Natyrës ka insistuar dhe investuar në drejtim të forcimit të bashkëpunimit, ndarjes së eksperiencës në rrjet dhe shtrirjes së veprimit në nivel lokal. Gjithashtu organizimi i ditëve të veçanta mjedisore me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të rrjetit të cilat përveç shtimit të vëmendjes dhe sensibilizimit për mbrojtjen e natyrës, kanë pasur si qëllim edhe promovimin e rrjetit. Një nga çështjet me të rëndësishme që u shtrua për diskutim, ishte edhe ajo nëse janë plotësuar pritshmëritë dhe kaluar sfidat për vitin e parë të punës në Rrjet. Për INCA-n dhe organizatat e tjera pjesëmarrëse në Rrjetin për Mbrojtjen e Natyrës kjo është një eksperiencë e re dhe koordinimi i veprimtarive të rrjetit duhet të thuhet që ishte i suksesshëm për vitin e parë.

Plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar Karaburun - Sazan

Vlorë 13 Mars 2014



Në kuadër të projektit “Përmirësimi i mbulimit gjeografik dhe menaxhimit efektiv të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare” mbështetur nga

UNDP dhe zbatuar nga WWF në bashkëpunim me INCA-n, në zonën e Orikumit në Vlorë u zhvillua takimi i parë me aktorët për përgatitjen e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar Karaburun – Sazan. Në takim morën pjesë aktorë të ndryshëm të qeverisjes qendrore dhe vendore, OJQ të ndryshme vendore, akademikë nga Universiteti i Tiranës dhe

Vlorës, përfaqësues të UNDP-së dhe grupeve të tjera të interesit.

Qëllimi i takimit ishte informimi i grupeve të interesit mbi dokumentin dhe procesin e zhvillimit të planit të menaxhimit, informimi i palëve të interesuara mbi strukturën dhe juridiksionin e ZMD Karaburun-Sazan, analizimi dhe identifikimi i vlerave natyrore, socio-ekonomike dhe kulturore për zhvillimin e zonës, si dhe krijimi i një vizioni për zhvillimin e zonës nëpërmjet metodave gjithëpërfshirëse.



Zhvillimi i aftësive të komunikimit të stafit të Zonave të Mbrojtura

Tiranë 12-13 Mars 2014

Specialistë dhe menaxherë nga 15 Zona të Mbrojtura të Shqipërisë kanë marrë pjesë në një trajnim kualifikues që aftëson stafin shqiptar të punojë në funksion të promovimit të parqeve kombëtare. Ekspertët e WWF u mesuan specialistëve të



Shërbimit Pyjor të përdorin teknikat e ndryshme të komunikimit në përçim të mesazhit të njohjes dhe mbrojtjes së parqeve. Tashmë menaxherët shqiptarë kanë fituar aftësitë bazë të komunikimit publik: të flasin me median, të punojnë me gazetarët, të përgatisin fletëpalosje apo udhëheqin grupe vizitorësh duke u zbuluar këtyre të fundit pasuritë natyrore dhe trashëgimime e çmuar që parku i tyre mban.

Abdulla Diku, koordinator për Shqipërinë në projektin Parqet e Harkut Dinarik thotë se “WWF beson në pasionin e njerëzve që e njohin parkun si shtëpinë e tyre. Kjo është arsyeja pse synojmë t’i aftësojmë ata të përdorin mjetet efikase të komunikimit në mënyrë që të bindin komunitetin lokal dhe publikun se ruajtja e natyrës së zonave të mbrojtura, është në përfitim të drejtpërdrejtë të vetë atij”. Parqet e Harkut Dinarik është një projekt i

angazhuar me ruajtjen dhe promovimin e një rrjeti rajonal prej 80 parqesh kombëtare që zbatohet në Shqipëri nga WWF Mesdhe dhe INCA (Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri).

Punonjësit e Shërbimit Pyjor në Shqipëri, apo të njohur në bote me termin “rangers” janë perceptuar deri me sot si shërbim publik i ngarkuar të mbrojë zonat e mbrojtura nga dëmtimet apo keqëbërësit; si zjarret, prerja e paligjshme e pemëve, gjuetia e paligjshme e kafshëve. Ekspertet e WWF sugjerojnë se ka ardhur koha, që përveç funksioneve menaxhuese dhe kontrolluese, Shërbimi Pyjor Shqiptar duhet t’i përgjigjet kërkesave të vizitorëve të natyrës duke ofruar me tej informim publik. Njohuritë që stafi i parqeve ka mbledhur në shumë vite shërbim, në të ardhmen do t’i ndajë me vizitorët,



komunitetit lokal, gazetarët, grupet e të rinjve, etj në mënyrë që mesazhi i ruajtjes së natyrës të arrijë mendjen dhe zemrën e publikut.

Përvoja e WWF me administratën pyjore të vendeve të Rajonit Dinarik, tregon se publiku ka qënë i kënaqur dhe mediat kanë reagur pozitivisht ndaj punës informuese të Shërbimit Pyjor.

Ekomuzeumi i Lumit Vjosa/Aoos kundërshton devijimin e planifikuar të këtij lumi.

Tiranë, 22 Mars 2014,

Dita botërore e ujit festohet çdo vit më 22 Mars dhe synon të fokusojë vëmendjen globale mbi ujin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Këtë vit tema e përzgjedhur është “Uji dhe Energjia” e cila kërkon të rrisë ndërgjegjësimin mbi ndërvartësin e këtyre të dyjave si dhe nevojën për të përdorur

zgjidhje dhe përqasje të integruara me qëllim arttijen e përfitimeve më të mëdha ekonomike, sociale dhe mjedisore. Ekomuzeumi i Lumit Vjosa/Aoos dhe rrjeti i tij ndërkuftar në mbështetje të komuniteteve dhe aktorëve lokal janë duke përfutur nga kjo mundësi për të ribërë prezent kundërshtimin e tyre të fuqishëm për devijimin e planifikuar të

Vijon në faqe 4

Vijon nga faqe 3

lumit Vjosa/ Aoos në pjesën Greke, ndërhyrje e cila është në kundërshtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe pritet të sjellë dëme të pariparueshme për vetë lumin, biodiversitetin e tij, jetesën e popullsisë në të dy vendet si në Greqi ashtu edhe në Shqipëri si dhe dëme për të gjithë zonën përrreth lumit si një e tërë .

Instituti Mesdhetar për Natyrën dhe Anthropolos (Med-INA) partneri lider i Ekomuzeumit në bashkëpunim me Zyrën e WWF në Greqi, Callisto, Autoritetin Menaxhues të Parkut Kombëtar të Pindus-it Verior dhe Bashkinë e Konicës, e cila do të ndikohet drejtpërdrejt nga devijimi, kanë përgatitur tashmë padinë ligjore për të kundërshtuar devijimin e propozuar dhe e kanë dorëzuar atë pranë Këshillit të Shtetit Grek (Gjykata e Lartë Administrative Greqisë). Kjo padi ligjore është mbështetur dhe firmosur edhe nga rrjeti Shqiptar i Ekomuzeumit, dhe shpresohet që rezultati i kësaj procedure të jetë tërheqja e plotë dhe afatgjatë e çdo plani devijimi mbi lumin Vjosa/ Aoos.

Lumi Vjosa/Aoos e ka origjinën nga shpatet veriore të maleve të Pindos-it në Greqi; ai bashkohet me dy degët kryesore të tij dhe më pas vazhdon të rrjedhë drejt Shqipërisë, ai udhëton edhe 190 km përpara se të derdhet në detin Adriatik. Zona më e madhe lumit, pjesë e cila i përket Parkut Kombëtar të Pindos-it Verior, është një vend me rëndësi të madhe për ruajtjen e natyrës, me një pasuri të habitateve ujore dhe tokësore dhe shumë lloje endemike dhe specie të mbrojtura të faunës dhe florës. Marrëdhëniet e popullsisë lokale me lumin dhe mjedisin përrreth kanë sjellë një trashëgimi të pasur kulturore dhe tradicionale. Në të njëjten kohë lumi dhe degët e tij perbejnë një burim jete të paçmuar për popullsinë në



të dy anët e kufirit, jetesa e të cilave varet kryesisht nga bujqësia dhe turizmi i moderuar. Edhe Ekomuzeumi i lumit Vjosa/Aoos ka për qëllim të mbrojtë dhe promovojë trashëgiminë e zonës natyrore dhe kulturore në të dy anët e kufirit greko-shqiptar. Devijim i planifikuar i rrjedhës së lumit Vjosa/Aoos do të transferojë 70×10^6 m³ ujë në vit nga baseni hidrologjik i lumit drejt basenit të Janinës, me qëllim prodhimin e energjisë si dhe pasurimin me ujë të Liqenit të Janinës. Kjo është një sasi shtesë mbi përafërsisht 10×10^6 m³ ujë që aktualisht i merret lumit çdo vit për të furnizuar stacionin hidroelektrik në burimet e Lumit Vjosa/Aoos, efektet e të cilave janë të dukshme në termat e kapacitetit të ujit. Kostoja mjedisore e ndërtimit dhe funksionimit të punës së planifikuar për devijimin e lumit është më e madhe se çdo përfitim potencial, duke marrë në konsideratë këtu faktin që diga do të ndërtohet brenda Parkut Kombëtar të Pindos-it Verior, punimet e planifikuara janë në kundërshtim me Direktivën Kuadër të BE-së për Ujin dhe sasia e energjisë që do të prodhohet nuk do të kalojë atë të tre turbinave të erës, këto janë disa nga arësyet që vlen të deklarohen.

22 Mars, Dita Botërore e Ujit

Tiranë, 22 Mars 2014,

Dita botërore e ujit festohet çdo vit më 22 Mars dhe synon të fokusojë vëmendjen botërore mbi ujin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Këtë vit tema e përzgjedhur është “Uji dhe Energjia” e cila kërkon të rrisë ndërgjegjësimin mbi ndërvartësin e këtyre të dyjave si dhe nevojën për të përdorur zgjidhje dhe përqasje të integruara me qëllim arritjen e përfitimeve më të mëdha ekonomike, sociale dhe

mjedisore.

Shoqëria civile dhe organizatat jo fitimprurëse prej kohësh kanë ngritur zërin për të mbrojtur dhe shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme burimet ujore të vendit dhe kryesisht ato të lumenjve. Sot jemi dëshmitar të një sulmi të pa precedent që i është bërë rrjetit hidrik të vendit, ku janë dhënë mbi 450 leje shfrytëzimi për ndërtimin e hidrocentraleve me një përfitim tepër minimal energjistik në *Vijon në faqe 5*

Vijon nga faqe 4 raport me dëmin mjedisor që ato shkatojnë. Dokumentacioni dhe procedurat e



ndjekura për “Vlerësimin e ndikimit në mjedis” në shumicën e rasteve nuk ndjekin standartet ligjore dhe ato të Bashkimit Europian; aq me tepër kjo në rastin e burimeve ujore me kontekst ndërkufitar. Efektet e para negative të vërejtura (mangesia e ujit, turbullira e shkaktuar, erozioni tokësor, dëmtimet e faunës, etj) dhe reagimet e komuniteteve lokale në disa komuna janë dëshmitë e para të pasojave të pritshme që do të kenë shpejt pasoja shumë herë më të rënda në mjedis dhe në mirëqënien e popullatave që jetojnë në këto basene.

Përpyekjet e organizatave të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës dhe veçanërisht të Institutit për Ruajtjen e Natyrës (INCA) kanë qënë përqëndruar në informimin e komuniteteve lokale dhe organeve vendore mbi vlerat dhe risqet potenciale të ndërtimit të hidrocentraleve, duke publikuar udhëzues për investitorët dhe institucionet shtetërore, duke kryer studime me karakter lokal e kombëtar, zbatuar miniprojekte për ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale, por edhe duke kërkuar në forma dhe mënyra të ndryshme reagimin e organeve shtetërore. Ne mbështetemi në këtë përpyekje rajonale edhe nga Fondi Botëror për Jetën e Egër (WWF) por edhe me grupimet dhe organizatat e tjera të vendit si PPNEA, EDEN, Eko-lëvizja.

Dy rastet që kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik dhe që kanë karakter ndërkufitar janë ato të Lumit Radika dhe Vjosës. Në rast se në rastin e parë ka pasur një reagim të shpejtë të organeve shtetërore shqiptare dhe maqedonase, deri më sot nuk kemi asnjë prononcim për rastin e planit për devijimin e

lumit Vjosa në pjesën Greke.

Para një viti me Vendimin 1005/4.9.2013 Këshilli Kombëtar i Ujërave në Greqi që miratoi “PLANIN E MENAXHIMIT TE LUMENJEVE NE QARKUN E EPIRIT”, dhe me vendimin e përbashkët 169278/8.7.2013 me Këshillin e Ministrave që miratuan “STUDIMIN STRATEGJIK TE NDIKIMIT MJEDISOR TE PLANIT TE MENAXHIMIT TE LUMENJEVE NE BASENIN E EPIRIT”, mori rrugë vendimarrja për devijimin e Lumit Vjosa në afërsi të burimit të saj për të transferuar 70.000.000 m³ ujë në vit nga baseni hidrologjik i lumit drejt basenit të Janinës, me qëllim prodhimin e energjisë si dhe pasurimin me ujë të Liqenit të Janinës. Të dy këto vendime janë kundërshtuar me padi pranë Këshillit të Shtetit Grek (Gjykata e Lartë Administrative Greqisë), e ngritur nga Instituti Mesdhetar për Natyrën dhe Anthropolos (Med-INA) në Greqi në bashkëpunim me Zyrën e WWF në Greqi, Callisto, Autoritetin Menaxhues të Parkut Kombëtar të Pindus-it Verior dhe Bashkinë e Konicës, e cila do të ndikohet drejtpërdrejt nga devijimi. Ky është një rast i mirë për të bashkuar



forcat në përmbyseje të vendimarrjeve politike të gabuara, nga të cilat demtohet edhe pjesa shqiptare dhe prandaj bëjmë thirrje të mbështesim peticionin në blogun <http://protectaoos.blogspot.com/> ku çdo kush mund të “firmosë” elektronikisht duke dhënë kontribut në pranimin e padisë dhe shpëtimin e Vjosës.

Ne mendojme se ky hap duhet përkrahur si një risi në lëvizjen e shoqërisë civile, duke ju drejtuar gjykatave për kundërshtimin e vendimeve të padrejta

Vijon në faqe 6

Vijon nga faqe 5 siç është ky i Vjosës, por edhe ato në vendin tonë ku lejet janë dhënë në territore të zonave të mbrojtura në shkelle të hapur me ligjin. Për këtë arsye mendojmë që në rast se qeveria shqiptare nuk kontrollon dhe rishikon lejet e

dhëna në kundërshtim me legjislacionin vendas, ashtu siç premtoi në fushatën elektorale, dhe ndalon hemoragjinë e hidrocentraleve të paqëndrueshëm në vendin tone, ne do ti drejtohem gjykatave për anulimin e lejeve të dhëna.

Vazhdon vlerësimi i vlerave dhe përfitimeve nga Parqet Kombëtare

Në datat 25 dhe 26 Mars, 2014 ekspertët e WWF dhe INCA (Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri) vijuan të mbledhin të dhënat shumëplanëshe mbi përfitimet që vijnë nga parqet kombëtare të Tomorrit dhe të Qafshamës. Dy takimet e radhës u zhvilluan në Roshnik dhe Krujë. Basenet ujëmbledhëse të këtyre dy parqeve dhe potenciali për të ngritur një turizëm të qëndrueshëm u cilesuan si vlerat prioritare me ndikim të rëndësishëm në natyrën dhe ekonominë lokale. Rreth 50 përfaqësues nga administrata pyjore, qeverisja qendrore, komunat, bizneset e ndryshme të zonave, shoqërië civile që punon në mbështetje të mjedisit, studiues, anëtarë të shoqatave të gjuetisë dhe menaxhimit të ujërave sollën kontribute të vlefshme në njohjen e gjendjes aktuale në keto dy parqe kombëtare të Shqipërisë.

dhe pasurive natyrore të parkut të Tomorrit janë baza e një destinacioni turistik të së ardhmes në këtë rajon”.

Qafshatama u vlerësua si një park relativisht i vogël por me vlera të larta kurative për cilesinë e mirë të ajrit dhe burimet e pasura ujore. Dikur vendpushimi i



Takimi për vlerësimin e përfitimeve nga Parku Kombëtar Tomorr, që u zhvillua në datën 25 Mars, listoi ndër të tjera përfitimet që vijnë nga larmia e jetës së egër në malin e Tomorrit, nga turizmi sportiv në Kanionet e Osumit dhe turizmi malor e fetar që praktikohet në vendet e kultit. Pjesëmarrësit thanë se “Ruajtja e trashëgimisë kulturore të qytetit të Beratit

familjes së mbretit Zog, parku ka shumë mundësi për zhvillimin e mirëfilltë të turizmit malor e kurativ si dhe grumbullimin e frutave arrorë. Klima e favorshme, masivet e pishave dhe produktet e shijshme ushqimore të Qafshamës janë të njohura në gjithë zonën.

Instrumenti për Vlerësimin e Përfitimeve nga Zonat e Mbrojtura (IVPZM) është një metodë e zhvilluar nga organizata WWF që kryen identifikimin e përfitimeve të dukshme e të padukshme që vijnë nga zonat e mbrojtura dhe analizon më tej kush i merr këto përfitime. Presioni për përdorimin e burimeve natyrore vijon të rritet mbi parqet kombëtare por WWF këmbëngul se duke njohur e përdorur eksperiencat më të mira ndërkombëtare, parqet kombëtare mund të ruhen dhe zhvillojnë në mënyrë të qëndrueshme, biznese që mbështesin ekonominë e banorëve.

NJOFTIME

- 1- Mediterranean Initiative Bulletin is now online.
http://wwf.panda.org/what_we_do/where_we_work/mediterranean/mediterranean_initiative_bulletin/mibulletin_issue4/
- 2- **Job Announcement Freshwater Officer.** WWF Mediterranean and its local partner Institute of Nature Conservation in Albania (INCA) are looking for a Freshwater Officer who will be responsible for leading and delivering the Albania component of WWF's project "Dinaric Arc Sustainable Hydropower Initiative II" (DASHI II). The project targets the hydropower development in the country with a vision towards more sustainable choices regarding hydropower development. The position is a full time, will be reporting to WWF Mediterranean and its local partner INCA and will be based in Tirana in INCA's premises. How to apply? Email a cover letter and CV to applications@wwfmedpo.org or info@inca-al.org with the subject line "Albania Freshwater Officer". **Deadline for applications: 7th April 2014.**
- 3- Shoqata Noé Conservation është duke kërkuar një Koordinator Programi për Programin e saj të titulluar "Menaxhimi i Ligatinave dhe konservimi i Pelikanit Dalmat në pellgun e Mesdheut". Projekti pilot i propozuar është 3-vjeçar e ka për qëllim të mbështesë menaxhimin e tre ligatinave të njohura, të gjitha të listuara si Ligatina me Rëndësi Ndërkombëtare nga Konventa Ramsar: Parku Kombëtar i Liqenit të Kerkinit në Greqi, Parku Kombëtar i Liqenit të Shkodrës në Mal të Zi dhe Parku Kombëtar Divjake-Karavasta në Shqipëri. Përgjegjësitë kryesore/Nën përgjegjësinë e ekipit të Departamentit Ndërkombëtar të Noé Conservation, me qendër në Paris, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë partnerët teknike, Koordinatorin e Programit, i bazuar në Shqipëri, do të zbatojë dhe menaxhojë programin në Shqipëri, Mal të Zi dhe Greqi. Objektivi i tij/i saj kryesor do të jetë sigurimi i zbatimit efektiv dhe në kohë, planifikimin, shpërndarjen, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve sistematike të programit të caktuar rajonal. Aplikantëve u kërkohet të dorëzojnë një letër motivimi, CV si dhe rekomandime me email (duke specifikuar në subjekt "Program Coordinator, Albania") në gjuhën Angleze, jo më vonë se data 15 prill 2014 në mesnatë (me orën Shqiptare) tek Peggy Poncelet pponcelet@noeconservation.org Shefe e Departamentit Ndërkombëtar të Noé Conservation. www.noeconservation.org.

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- *Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në buletin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes buletinit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!*
- *Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENIOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.*

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro